

Mrika LIMANI

**PERSPEKTIVA MBI ELEMENTËT ANTIKOLONIALISTE
GJATË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE NË KOSOVË**

Punimi gjurmon në mënyrë tematike paraqitjen e grupeve të armatosura guerile gjatë Luftës së Dytë Botërore në Kosovë duke e vendosur veprimtarinë e tyre brenda diskursit antikolonialist, dhe në këtë formë tenton të gjurmojë elementët përkufizuese antikolonialiste brenda kontekstit kohor në të cilin kanë vepruar. Në këtë mënyrë, punimi ndjek trajktoren e historikut të paraqitjes së tyre, shtjellon platformat politike dhe ideologjike që këto grupe kanë përvetësuar, si dhe i trajton pozicionimet e tyre politike në kontekstin shqiptaro-jugosllav dhe brenda botëkuptimit të Frontit të përbashkët Nacional Çlirimtar, duke e vendosur përqendrimin e diskutimit te ballafaqimi me përafrimet ideologjike por edhe te tensionet ndëretnike dhe zgjidhjen e këtyre problemeve brenda vijave të pranueshme ideologjike dhe në mbrojtje të sentimenteve kombëtare.

Përpos burimeve parësore arkivore vendase, atyre ndërkombëtare, dhe atyre jugosllave të botuara, punimi vë në dispozicion një shumëllojshmëri të literaturës historike të botuar gjatë periudhave të ndryshme kohore, me qëllim të posaçëm për t'i qëndruar historikisht besnike shtjellimeve dhe përfundimeve historike paraprake duke e respektuar kontekstin politik dhe kohor në të cilin janë botuar, dhe njëkohësisht duke e kombinuar me literaturën bashkëkohore historike, me qëllim të ndjekjes së trajktores antikoloniale si interpretim i sotëm i këtyre lëvizjeve emblematike të shekullit XX.

Lufta e Dytë Botërore në Kosovë i kishte të kombinuara shumë dimensione të luftës të polarizimeve mes grupeve të vogla luftëtarësh të kombinuara me interesa qoftë lokale qoftë kombëtare. Këtu kishte dhe një rrjet të ndërlikuar të kolaboracionizmit - i cili ishte vendosur në një kontekst të diskursit politik për mbijetesë kombëtare dhe i vendosur si mbrojtës i interesave të shtetformimit të Shqipërisë natyrale. Kjo situatë i dha një dimension tjetër luftës në Kosovë. Përderisa shtetet evropiane po luftonin si tabore ideologjike, shqiptarët po i bashkoheshin kauzave ideologjike më

shumë në mënyrë të kalkuluar dhe pragmatike, por jo gjithherë pa ideologji, duke vepruar në atë formë që do të shpinte rreth zhbërjes së statusit të të nënshtruarit në kontekstin ballkanas. Në këtë kuptim, mund të argumentohet që edhe në Kosovë lufta ishte totale.

Kur flasim për rezistencë antikoloniale në kontekst shqiptar parasysh i kemi dy situata: antikolonializmi klasik i shpërfaqur përmes tezave të frontit të Luftës Nacionalçlirimtare, dhe së dyti antikolonializmi i shfaqur në kuptimin nacionalist të fjalës. Në kuptimin e së parës parasysh e kemi trajektoren historike të zhvillimit të lëvizjeve nacionalçlirimtare kundër fashizmit dhe nazizmit, lufta e të cilëve përkthehej në fronte të ndasisë ideologjike. Përderisa fronti nacionalçlirimtar e ndiqte një traditë socialiste ideologjike, me synime më liberale, ai front gjithashtu kishte ide konkrete për riorganizime shtetërore, politike dhe shoqërore pas përfundimit të luftës. Këto organizime në kontekst ballkanas parashiheshin të merrnin karakter të shteteve federale me një sistem socialist të ndërveprimit politik dhe shoqëror. Në këtë mënyrë, rezistenca antikolonialiste në Jugosllavi dhe Shqipëri mori karakter të çlirimit nacional/kombëtar si proces kalimtar në zhvillimin e trajektores së revolucionit socialist, dhe njëkohësisht mori karakter të një lufte të klasave, që u shpërfaq si formë e luftës civile.¹

Nëse e përvetësojmë kolonialin komunist për të treguar qasjen e tyre ndaj zgjidhjes së çështjes shqiptare, atëherë i bie që bindjet nacionaliste/kombëtare të ky grup i antikolonialistëve artikulohehin përmes parimit për vetëvendosjen e kombeve si hap parësor për çlirim nga sistemet politike që mbajnë shtresën borgjeze në pushtet.

Për këtë grup antikolonialistësh, pushtuesi ishin fashistët dhe nazistët, të cilët me praktikën e tyre shtypëse, raciste dhe shfarosëse, dhe vendosjen e marrëdhënieve tipike kolonialiste ndërmjet shtetit dhe shoqërisë shqiptare dhe atyre si forca eprorë, po luftonin kundër sovranitetit thelbësor të qenies politike të shtetit shqiptar, si dhe po luftonin kundër konceptit të jetës së lirë e të dinjitetshme, që ishte e drejtë njerëzore e çdo njeriu që lind - pavarësisht racës, religjionit ose kombësisë. Në një botë post naziste, përbrendësimi i vlerave të lirisë universale konsiderohet si një element i mirëqenë i karakterit të njeriut modern, por atëbotë duket se përbrendësimi i vlerave të tilla ishte i pamundur karshi një lufte të përhershme për mbijetesë kombëtare - gjë që e shpjegon pjesërisht dikotominë antikolonialiste të krijuar tek shqiptarët gjatë kësaj periudhe,

¹ Enzo Traverso, *Fire and Blood: The European Civil War 1914-1945*, trans. David Fernbach, English-language edition (London ; New York: Verso, 2016), 59.

dhe për më tepër që antikolonializmi ishte shpërfaqur historikisht si mbrojtje kundër kolonializmit serb.

Përtej këtij vështirimi, lufta u shpërfaq në forma të ndryshme të dhunës e gjithherë me më shumë se një doras: dhunë selektive, dhunë individuale, dhunë joracionale dhe dhunë shfarosëse. Secili element i dha një dimension tjetër luftës dhe kontribuoi që të largoheshin edhe më shumë polet e armiqësuar nga njëra-tjetra, që solli përfundimin e luftës me shpërthim të madh të dhunës kundër civilëve. Siç vëren Traverso, në këto raste kur dhuna merr dimensione shumë të mëdha, atëherë ajo shndërrohet në mizori.² Dhe nga ky element nuk mund të shkëpusim kurrsesi Luftën e Dytë Botërore qoftë në nivel vendor a ndërkombëtar, pa e treguar atë si luftë totale, luftë e revolucioneve e luftë civile, e bashkëkryer me dhunë gjenocidale.³

Në mënyrë pothuajse të teleologjike, ky përfundim katastrofal i vendosi themelet për krijimin e një diakronie tjetër të shtypësve dhe të shtypurve që e ndoqi trajektoren historike të renditjes sociale dhe politike në Jugosllavi përgjatë ekzistencës së saj pothuajse gjashtëdhjetëvjeçare.

Ndryshe nga grupi i parë i rezistencës antikolonialiste, lufta antikolonialiste e grupeve nacionaliste përkthehej si luftë ndërmjet kombesh. Si mësim i vyeshtë nga historia, për këtë grup antikolonialistësh, pushtuesit ishin serbët dhe më specifikisht Jugosllavia. Kështu që, çdo veprim që ndërmerrnin ata për të çuar përpara kauzën e tyre politike kishte të bënte me luftimin e frontit nacionalçlirimtar të cilin këta e perceptonin si promovues të Jugosllavisë kolonialiste. Shumë ngjashëm me vende të tjera të Evropës, edhe në trojet shqiptare (që gjatë kësaj periudhe iu ndryshuan disa herë kufijtë) lufta përfshiu brenda vetës një revolucion shoqëror dhe politik që e ndryshoi përfundimisht trajektoren historike të Shqipërisë dhe Kosovës.

Në një vështirim më të gjerë, historia e kësaj periudhe nuk duhet shikuar si përkthim i një ligjërimi të luftës kombëtare dhe antikombëtare, meqë një qasje e tillë vetëm sa i zhveshë aktorët historikë nga incentivat e tyre burimore përmes të cilave kanë vepruar. Për më tepër, është një hipokrizi me specifika të dukshme antishkencore kur tentohet të vendosim situata historike të kaluara në rrethana dhe ligjërimi të sotme kombëtare dhe antikolonialiste. Për Kosovën në kuptimin territorial që e njohim sot, trajektorja historike e Luftës së Dytë Botërore nisë me pushtimin e Jugosllavisë nga Fuqitë e Boshtit që filloi më 6 prill 1941, ndërkaq

² Ibid., 86.

³ Ibid., 92.

Jugosllavia u dorëzua më 15 prill të po atij viti.

Pas pushtimit filluan edhe diskutimet për vendosjen e një vije demarkacioni të zonave të pushtuara ndërmjet fuqive pushtuese, Italisë, Bullgarisë dhe Gjermanisë, që pasoi me përfshirjen e një pjesë të Kosovës brenda territorit të Shqipërisë.⁴ Në këtë kuptim, është e një rëndësie të posaçme të kontekstualizojmë edhe tentativat për bashkëveprim ndërmjet dy grupeve shqiptare antikolonialiste, sepse kjo tregon edhe për një pikëpajtim të synimeve ndërmjet grupeve respektive. Në këtë kuptim, e vendosim edhe organizimin e Konferencës së Tapizës⁵, në korrik të vitit 1942, atë të Mukjës në gusht të vitit 1943. Në Tapizë, për shembull, formimi i “Komitetit për Shpëtimin e Shqipërisë”, ishte kallëzues që të dy grupet luftonin kundër fashizmit në kontekstin e fashizmit italian, por edhe për plotësimin e pavarësisë së Shqipërisë me kufijtë natyralë të saj,⁶ një jehonë e ngjashme me rezolutën e Bujanit, më 1943-1944.

Elemente të fjalëpërfjalshme antikolonialiste e karakterizuan edhe takimin e Mukjës në gusht të 1943, ku synohej mes të tjerave të anulohet edhe vendimi i Asamblesë së 12 prillit 1939 që i kishte dhënë Viktor Emanuelit III kurorën e Shqipërisë.⁷ Në këtë aspekt duhet shikuar edhe pozitën e shtetit të Shqipërisë, si shtet amë i shqiptarëve të Kosovës, karshi këtyre zhvillimeve. Është e vështirë të argumentohet që brenda rrethanave, shteti ishte plotësisht sovran. Siç ndodhi edhe në vende të tjera në Evropës, si në: Greqi, Jugosllavi, Norvegji e Francë, edhe në Shqipëri u krijuan disa regjime që i trajtuan fashistët dhe nazistët si aleatë, përderisa këta të fundit vendosën një hierarki pushteti klasik të kolonializmit ekonomik.

Përderisa në ligjërimet të periudhës socialiste të Shqipërisë çështja e pushtimit të Shqipërisë dhe rrjedhimisht tokave shqiptare ku përfshihet edhe Kosova, u trajtua si çështje e një pushtimi me karakter kolonial - shfrytëzim të fuqisë punëtore dhe të resurseve ekonomike⁸ - në ligjërimet e periudhës së pas komunizmit në Shqipëri e shohim të shpërfaqur një

⁴ I njohur si operacioni Mariza, Bundesarchiv Freiburg, RW F/v. 588, 103-106.

⁵ Paskal Milo, *Shqiptarët Në Luftën e Dytë Botërore*, vol. 1 (Tiranë: Botimet Toena, 2014), 391-92.

⁶ Ibid., 1:392.

⁷ Ibid., 1:395. Shih dhe Zejnullah Gruda, “Procesi Dhe Likuidimi i Pamvarsisë Së Shqipërisë, Më 7 Prill 1939,” *Përparimi*, no. 1-2 (1963): 26-37. Shih dhe Xhelal Gjeçovi, *Çështje të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare - Gjykimi mbi luftën pas shtatëdhjetë vitesh* (Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2014), 254-59.

⁸ Marenglen Kasmi, *Pushtimi gjerman i Shqipërisë: 1943-1944; (një këndvështrim në dritën e dokumenteve gjermane)* (Tiranë: Shtëpi Botuese et Studio Grafike et Shtypshkronjë Filara, 2013), 75-77.

tendencë për të shënuar dallime ontologjike ndërmjet karakterit të pranisë italiane dhe gjermane. Përderisa pushtimi fashist paraqitet si fuqi koloniale që erdhi në Shqipëri përmes agresionit ushtarak, prania e fuqisë naziste në Shqipëri trajtohet ndryshe. Theksi shpesh bie te fakti që gjermanët e mbështeten idenë e Shqipërisë së pavarur me pozitë asnjënjëse në luftë dhe nuk ishin të dhunshëm në raport me civilët vendas.⁹

Këtu rikujtojmë që Neubacheri, si diplomant gjerman e trajtonte Shqipërinë si territor të kolonizuar: “Çdo gjë që ka ndodhur kohët e fundit për ngritjen e shtetit shqiptar, bazohet mbi faktin e padiskutueshëm të pranisë sonë në këtë vend. Prandaj është një kërkesë tepër e vetëkuptueshme e gjermanëve, që ne nuk lejojmë që në çështje të qeverisë, të vihem përpara fakteve të kryera. Kjo kërkesë e gjermanëve bazohet mbi faktin fundamental, që asnjë qeveri shqiptare nuk është në gjendje të veprojë dhe të ushtrojë autoritetin e saj pa ndihmën tonë”.¹⁰

Në këtë kontekst, është e rëndësishme të citojmë një ligjëratë të Mehdi Frashërit në raport me atë sesi Regjenca e Lartë e perceptonte pozitën e gjermanëve në Shqipëri: “...Vetëm një gjë nuk duhet të harrojmë, se ndodhemi në një kohë lufte. Asnjë shtet në Ballkan nuk ka mbetur pa u okupue prej ushtrive ndërluftuese, mik ose armik. Ashtu edhe Shqipëria sot ndodhet nën okupacionin e ushtrisë gjermane, por kjo ushtri ka ardhur si ushtri e një shteti mik dhe jo armik e luftues kundër nesh... Ndejti e saj në tokat tona asht e lidhun me ngjarjet e luftës dhe mund të zgjatet disa javë ose disa muaj, por gjithmonë është e përkohshme dhe kjo gjë në asnjë mënyrë nuk i gjason aneksimit kolonial të përhershëm si ajo e Italisë...”.¹¹

Kjo shkëputje është posaçërisht relevante për trajtesën tonë meqë hedhë dritë mbi botëkuptimet politike të akterëve të asaj periudhe, por edhe sesi i përkthenin ato botëkuptime në praktikë. Megjithatë, nëse e vendosim këtë shkëputje në diskursin e sotëm post kolonial, hasim në disa probleme tautologjike që bien ndesh me pohimet kryesore të fjalëdhënësit: akterët duket sikur e pranojnë se ekziston një hierarki e pabarazisë ndërmjet gjermanëve dhe shqiptarëve dhe se kjo hierarki imponohet në mënyrë të sforcuar përmes prezencës dhe epërsisë evidente ushtarake të gjermanëve, të cilët shqiptarët nuk do të mund t'i kundërviheshin dot; situata e përgjithshme botërore imponon një pozitë të tillë dytësore (lexo të

⁹ Muharrem Dezhgiu, *Shqipëria nën pushtimin italian (1939-1943)* (Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2005), 489.

¹⁰ Marenglen Kasmi, *Pushtimi gjerman i Shqipërisë: 1943-1944; (një këndvështrim në dritën e dokumenteve gjermane)*, 134.

¹¹ Muharrem Dezhgiu, *Shqipëria nën pushtimin italian (1939-1943)*, 487.

kolonizuar); në krahasim me Italinë, ku ardhja koloniale kishte ambicie të jetësohet përherë, te gjermanët një situatë e tillë është e përkohshme.

Nëse bazohemi në burimet historike, atëherë është e qartë që kishte dallime ndërmjet mënyrës sesi u manifestua prania e italianëve dhe gjermanëve tek shqiptarët, përderisa të parët ishin dukshëm më të dhunshëm në raport me civilët, ndërkaq të dytët më pak asisoj. Në kontekstin e përgjithshëm historik, ky fakt padyshim se mban një vlerë për shënim historik, por në kontekstin e diskursit antikolonial, ky fakt nuk mban vlerë aq të madhe sa për të minimizuar karakterin kolonial të një fuqie krahas tjetrës. Këtu duhet përmendur që gjermanët u siguruan që të zhduket ari i thesarit kombëtar shqiptar, të cilin fillimisht e kishin përvetësuar “për ta ruajtur” italianët.¹² Në anën tjetër, duhet të kontekstualizohet edhe roli i Ballit Kombëtar në kuptim të qasjes dhe rolit përkatës historik. Siç vëren Dezhgiu, meqenëse Lëvizja Nacionalçlirimtare e kishte hedhur poshtë marrëveshjen e Mukjes në Konferencën e Dytë Nacionalçlirimtare të Labinotit (4-9 shtator 1943), atëherë kjo ia kishte imponuar Ballit Kombëtar që të afrohej me gjermanët.¹³

Për të vendosur diskutimin edhe më shumë brenda shtigjeve të tematikës së përcaktuar, duhet të kemi parasysh që qeverive shqiptare të formuara atëbotë i mungonte një element thelbësor demokratik, që i duhet çdo qeverie për të kërkuar legjitimitet - përzgjedhja e qeverisë në bazë të votimit të lirë.¹⁴ Në këtë pikë, siç e vëren edhe Milo, pavarësia ndërkombëtare e Shqipërisë dhe trojeve shqiptare që bënin pjesë brenda kufijve, u venit.¹⁵ Por, për të gjurmuar historinë e antikolonializmit, duhet ta kemi parasysh se ajo merr dimensione të ndryshme varësisht në cilin kontekst historiko-gjeografik vendoset ajo. Nga natyra e tyre, lëvizjet antikolonialiste i nënshtrohen rregullave të përkufizimeve teorike që e qartësojnë mënyrën dhe pikënisjen nga e cila shtjellohen lëvizjet për çlirim. Në kuptimin tradicional historik, antikolonializmi ndërlidhet me luftërat çlirimtare trikontinentale kundër imperializmit, dhe në këtë formë ato gjurmohen praktikisht nga periudha e pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore dhe fillimi i dekolonizimit në nivel global.

¹² Alexandra De Renzy Channer, “Defeat and Resurrection: A Political History of the Pan-Albanian National Revolutionary Movement, 1912-2010” (Dissertation, University of Pennsylvania, 2012), 2015.

¹³ Muharrem Dezhgiu, *Shqipëria nën pushtimin italian (1939-1943)*, 478.

¹⁴ Marenglen Kasmi, *Pushtimi gjerman i Shqipërisë: 1943-1944; (një këndvështrim në dritën e dokumenteve gjermane)*, 88.

¹⁵ Paskal Milo, *Shqiptarët në luftën e dytë botërore*, 1:115.

Në një kuptim më të gjerë teorik, lëvizjet antikolonialiste mund të gjurmohen që nga përkufizimi i tyre ontologjik, dhe në këtë formë i shohim të shfaqura nëpër ciklet e ndryshme historike të historisë botërore. Kjo karakteristikë themelore që i dallon lëvizjet antikoloniale në përgjithësi nga kryengritjet dhe format tjera të rezistencës, është përvetësimi i një ligjërimi qendror që i vendos strukturat e pushtetit si fuqi shtypëse në raport me akterët e rezistencës. Në këtë formë, antikolonializmi karakterizohet nga një kundërshtim kryengritës që refuzon dominimin e huaj dhe humbjen apo mungesën e pavarësisë. Në këtë kuptim i gjurmojmë historikisht edhe luftërat antikolonialiste kundër dominimit evropian, si rezistenca në Karaibe (që nga 1519 e deri në 1844), Revolucioni Amerikan, kryengritjet kundër skllavërisë në Karaibe dhe Amerikën Latine, luftën për çlirimin nën udhëheqjen e Toussainti’Ouverture në Haiti (1791-1804), luftërat “Kaffir” (1799-1878), lëvizjet çlirimtare për çlirim në Amerikën Jugore nën udhëheqjen e Simon Bolivarit (1817-1829), kryengritja kundër Britanisë së Madhe në Indi (1857)¹⁶, luftërat e Maorit (1860-1872), kryengritjet e 1916 në Irlandë, kryengritja e Mau Maut (1952-1959), kryengritja e Hungarisë (1956), e lufta e Vietnamit (1960-1974).¹⁷

Duke i vendosur në këtë dritë kryengritjet antikolonialiste, i hapim shtigjet për të vënë diskutimin mbi lëvizjet dhe luftërat antikolonialiste, që funksiononin të udhëhequra nga dinamikat mbarëbotërore të sundimit dhe shtypjes, si dhe dimensionet e shumëllojshme sesi subjekti i shtypur përkufizohej. Në vazhdë të diskursit tematik e kemi parasysh edhe shpjegimin e Saidit mbi proceset diskursive të tjetërsimit që i kanë vendosur nocionet perëndimore si koncepte superiore krahas, të themi, orientalizmit, kështu duke e vënë në pah se si krijohet “tjetri i huaj” jo vetëm përmes kolonializmit, por duke ia mohuar edhe arritjet vetanake kulturore. Siç vëren Saidi, “tjetri” ndërtohet dhe identifikohet prej mangësive, kuptohet gjithmonë në krahasim me fuqinë sunduese.¹⁸ Kjo qasje është shumë relevante për diskutimin tonë, sepse e vendos në diskurs konceptin e “tjetrit” të portretizuar gjithherë si inferior dhe të prapambetur - por që në këtë qasje vetëm shpaloset prapavija koloniale e ligjëruesit dhe politikat shtypëse që vazhdon t’i ndjekë. Siç vëren edhe Gopal, çlirimi nga paternalizimi kolonial

¹⁶ Priyamvada Gopal, *Insurgent Empire: Anticolonial Resistance and British Dissent* (London ; New York: Verso, 2019), 41.

¹⁷ Robert Young, *Postcolonialism: An Historical Introduction* (Oxford, UK ; Malden, Mass: Blackwell Publishers, 2001), 161.

¹⁸ Andrea Komlosy, *Work: The Last 1,000 Years*, trans. Jacob K. Watson dhe Loren Balhorn (London Brooklyn, NY: Verso, 2018), 184.

(duke i konsideruar si “tjetri” dhe i “huaji”) është pjesë e procesit historik të dekolonizimit.¹⁹

Në dritë të kësaj, i hapim shtigjet për të vënë diskutimin mbi lëvizjet dhe luftërat më specifike antikolonialiste, që vepronin të udhëhequra nga dinamikat universale për çlirim kombëtar dhe medoemos refuzonin të vepronin brenda margjinave përkufizuese të sunduesit. Në këtë kuptim i parashtrijmë edhe lëvizjet antikolonialiste shqiptare në Kosovë gjatë Luftës së Dytë Botërore, duke ndjekur trajektoren historike të zhvillimit të tyre si lëvizje me platforma antikolonialiste mbi bazën e së cilave u themeluan si grupe luftimi të gueriles. Në kontekstin e caktuar kohor të Luftës së Dytë Botërore, kurdo që flitet për guerilët, parasysh i kemi partizanët. Këtu e kemi parasysh që brenda denominativitanti kolonial bëjnë pjesë edhe grupet e tjera me karakter nacionalist që nuk përvetësonin platforma politike të majta. Këto grupe i shohim si të tilla në raport me qëndrimin e tyre karshi fashistëve dhe nazistëve dhe që nuk merrnin pjesë në strukturën shtetërore shqiptare që vepronte në atë kohë. Në këtë aspekt ndërtohet një dikotomi e grupeve ndërluftuese, gjegjësisht njësitet e rregullta ushtarake që vepronin përbrenda një sistemi shtetëror (1941-1944) dhe ato që vepronin të pavarura dhe në kundërshtim me administrimin shtetëror.

Karakteri antikolonialist me natyrë nacionaliste ishte posaçërisht i evidentuar te organizimet si Balli Kombëtar dhe Legaliteti. Balli Kombëtar përfaqësonte një organizatë antikomuniste dhe antizogiste, themelimi i së cilës ishte reaksion kundërshtues ndaj dominimit komunist në Frontin e sapoformuar Nacionalçlirimtar. Megjithëse grupet antikomuniste ishin të pranishme në shoqërinë shqiptare, si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë, Balli Kombëtar e shënon një organizim më të përmbledhur kundër komunizmit.²⁰ Qëndrimet e Ballit Kombëtar në raport me zhvillimet politike përputheshin në disa pika, si p.sh. në kundërshtimin e kthimit të Mbretit Zog si udhëheqës i shtetit shqiptar dhe ata gjithashtu e mbështetnin idenë e formimit të një republike më demokratike dhe sekulare.²¹ Balli Kombëtar udhëhiqej nga një Komitet Qendror, anëtarë të së cilës ishin disa figura me autoritet në shoqërinë shqiptare, si: Mithat Frashëri, Fuat Dibra, Faik Qyky, Nuredin Vlora, Ali Këlcyra, Hasan Dosti dhe Kolë Tomara.²² Ata kishin gjithashtu një memorandum themelimi, i mbiquajtur Dekalogu,

¹⁹Priyamvada Gopal, *Insurgent Empire*, 18.

²⁰Hubert Neuwirth, *Widerstand Und Kollaboration in Albanian 1939-1944*, Albanische Forschungen (Wiesbaden: Harrassowitz Verlag, 2008), 96-99.

²¹Ibid., 100.

²²Ibid.

në të cilën i numëronin arsyet se pse shqiptarët duhej të luftonin për flamurin kuq e zi dhe për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve.²³ Qëndrimi i tyre ishte se shqiptarët duhej të luftonin kundër pushtuesve.²⁴

Legaliteti si organizatë e formuar nga Abaz Kupi kishte gjithashtu për synim të luftonte kundër pushtuesve, por që të mblidhte rreth vetës individë që nuk pajtoheshin as me qëndrimet e komunistëve as të Ballit Kombëtar. Për më tepër, Abaz Kupi ishte mbështetës i idesë së kthimit të Mbretit Zog dhe i perceptonte forcat e huaja pushtuese në veçanti si pushtues të mirëfilltë që duhej luftuar.²⁵

Çështja e natyrës antikolonialiste me karakter nacionalçlirimtar te partizanët gjatë Luftës së Dytë Botërore, në përgjithësi, mund të gjurmohet te frontet e përbashkëta që ndërtuan komunistët si përgjigje ndaj rritjes së fashizmit në nivel ndërkombëtar. Kjo çështje ishte sqaruar edhe në trajtesën e Titos, të quajtur *Pyetja kombëtare në Jugosllavi në dritë të Luftës Nacionalçlirimtare*²⁶, gjë që kishte pasur efekt te komunistët shqiptarë në Jugosllavi. Këtë trajtesë të Titos duhet gjurmuar nga Kongresi i Katërt i Partisë Komuniste të Jugosllavisë, mbajtur në Dresden në vitin 1928, në të cilën iu njoh e drejta për shkëputje edhe minoriteteve të Jugosllavisë, gjë që nuk vlente edhe më parë, kur supozohej se këtë të drejtë e mbanin vetëm kombet më të mëdha të Jugosllavisë.²⁷ Ambicia për vetëvendosje deri në shkëputje, në fakt kishte rrënjë shumë më ideologjike sesa i atribuohet në shumicën e trajtesave historike. Kominterni, për shembull, sipas vijës së mendimit leninist, ishte shtytës i fuqishëm i idesë së vetëvendosjes deri në shkëputje. Për më tepër, internacionalistët e Kominternit e trajtonin Jugosllavinë e parë si shtet tipik kolonialist në raport me minoritetet e saja.²⁸ Këtu duhet kujtuar që Partia Komuniste Jugosllave e themeluar më 1919, e kishte veprimtarinë e saj të ndaluar që nga viti 1921 në Jugosllavi.²⁹

²³ Alexandra De Renzy Channer, "Defeat and Resurrection: A Political History of the Pan-Albanian National Revolutionary Movement, 1912-2010", 225.

²⁴ Hamit Kaba dhe Sabit Syla, *Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore: Arkivat Kombëtarë Britanikë* (Prishtinë: Instituti i Historisë - Prishtinë; Instituti i Historisë - Tiranë, 2018), 290.

²⁵ Arkivi i Kosovës, Komiteti Krahinor i L.K. të Kosovës; Fondi i Shqipërisë, 1942-1944, sig. 15.

²⁶ Jasna Jozelic (eds.) Gorana Ognjenovic, *Revolutionary Totalitarianism, Pragmatic Socialism, Transition: Volume One, Tito's Yugoslavia, Stories Untold*, 1st ed. (Palgrave Macmillan UK, 2016), 70.

²⁷ Ibid., 77.

²⁸ Ibid., 76.

²⁹ Klaus Schmider, *Partisanenkrieg in Jugoslawien 1941-1944* (Hamburg: Mittler, 2002), 27.

Kjo periudhë përkon me një kohë kur politikat socialiste ndërkombëtare udhëhiqeshin nga shtysa për të vendosur politika të majta dhe për të nisur revolucion social dhe politik, gjë që dallonte nga periudha kur rrymat socialiste të mendimit po zhvilloheshin nëpër vende ku revolucion kishte përfunduar (gjatë LDB-së), që përkon më tepër me periudhën e mëvonshme të “real-socializmit”. Në këtë kuptim, ka hapësirë të interpretojme që lufta e quajtur “nacionalçlirimtare” kishte karakter leninist që kërkonte bashkimin e disa grupeve të njerëzve që prireshin nga interesat e përbashkëta dhe kishin prapavijë kulturore dhe gjuhësore të ngjashme. Për më tepër, politikat për ndërtimin e këtij Fronti Popullor gjurmohen te mbledhja e 7-të e Kominternit, mbajtur në Moskë, ku në përgjithësi kërkohet përpilimi i një strategjie të re politike në përshtatje me rrethanat e reja në të cilat social-demokratët dhe fashistët ishin paraqitur si forca antagoniste në raport me komunistët e kohës.³⁰ Këtë zhvillim duhet shikuar edhe në kontekst të përhapjes së dimensioneve nacional-centrike të të majtëve në Evropë, gjë që në përgjithësi e dëmtonte kauzën komuniste dhe ia dobësonte potencialin politik përbrenda vetë shteteve në të cilat partitë komuniste merrnin pjesë në demokracitë parlamentare respektive.

Këto zhvillime gjithashtu ndërlidheshin me pamundësinë praktike të Moskës të udhëhiqte përmes Kominternit me politikat komuniste ndër shtete të tjera, kryesisht meqë kishte llojllojshmëri të madhe të shteteve në të cilat partitë komuniste vepronin dhe në këtë formë e pamundësonin qasjen e Moskës në strukturat e pushtetit (si shtete me zhvillim të lartë industrial, shtete me substrat të madh shoqëror të fshatarësisë pa ndonjë zhvillim të dukshëm social, apo shtete të kolonizuara).³¹ Ndërkaq, në gjurmimin më të gjatë në raport me natyrën anticoloniale të këtyre lëvizjeve, janë dy elemente të posaçme që bien në sy. E para, lëvizjet anticoloniale në sensin nacional të fjalës (si lëvizje nacionalçlirimtare) u zhvilluan përbrenda diskursit marksist (më tutje të përkthyer si trockiste, në kuptimin që e përvetësonin idenë për revolucion të përhershëm deri në socializëm) përderisa revolucion i parashihej si lëvizje për ngritjen e vetëdijes politike dhe përkthimit të kësaj vetëdije në nivel praktik. E dyta, kjo nismë në nivel të gjerë, dhe e parashikuar të zhvillohej nga poshtë sipër dhe jo e diktuar nga elita te populli, parashihej që patjetër të përfshinte elementin kombëtar si denominativ njësor i shoqërive agrare.³²

³⁰ Jonathan Haslam, “The Comintern and the Origins of the Popular Front 1934-1935,” *The Historical Journal* 22, no. 3 (1979): 683.

³¹ Ibid.

³² Robert Young, *Postcolonialism*, 156.

Në diskursin e përgjithshëm post kolonial të lëvizjeve antikolonialiste ekziston dallimi përkufizuese ndërmjet kryengritjes ose rezistencës antikoloniale dhe antikolonializmit si pozitë politike në teori.³³ Të dyja këto pikënisje zakonisht përputhen në mënyrën se si praktikja dhe teorikja bashkëveprojnë të lëvizjet antikoloniale, ose në mënyrën sesi këto lëvizje e përkufizojnë pozitën e tyre brenda strukturave të pushtetit në të cilat jetojnë dhe në mënyrën sesi planifikojnë të rindërtojnë këto hierarki të pushtetit.

Në këtë mënyrë parasysh e kemi edhe variacionin e madh ndërmjet lëvizjeve antikoloniale në nivel global dhe kontekstet e ndryshme socio-historike në të cilat këto lëvizje paraqiten. Antikolonializmin mund ta trajtojmë si të shpërfaqur në shumë forma, qoftë si kundërshtim moral i rendeve shtypëse (që kanë të bëjnë me të drejtat civile dhe kundër skllavërisë), kundërshtim i fuqive imperialiste dhe pushtetit të tyre, artikulum i të drejtave politike dhe synimeve për çlirim dhe vetëvendosje, apo edhe antikolonializëm nacionalist, e të tjera.³⁴ Për rastin në shqyrtim mund të argumentohet që grupet kishin karakter të lëvizjes antikoloniale, sepse përpos që luftonin kundër një sistemi shtypës dhe eksploativ, ata e përvetësonin edhe një platformë të caktuar ideologjike dhe politike, vendosjen në fuqi të së cilës e kishin synim përfundimtar dhe në këtë formë nuk ishin të reduktuar vetëm në kundërshtim të armatosur pa ndonjë strategji konkrete për marrje dhe vendosje të pushtetit.

Edhe kundërshtimin ndaj kolonializmit duhet ta kontekstualizojmë përbrenda partizanëve shqiptarë në Jugosllavi. Si shembull, Ali Aliu, një komunist nga Presheva, ishte politicizuar përmes edukimit komunist që e kishte marrë nga partizanët shqiptarë në Shqipëri më 1942, ku ishte njoftuar më detajisht me historinë e kolonializmit.³⁵ Përderisa grupet e para luftuese partizane ishin formuar në Bashkimin Sovjetik në vitin 1941, praktikë që u ndoq shpejt edhe nga vendet e tjera në këtë periudhë, përfshi këtu edhe Jugosllavinë kur grupet e vogla të armatosura partizane u shndërruan në njësite të rregullta ushtarake dhe me të cilin rast u formua Ushtria Nacionalçlirimtare³⁶, paraqitjen e partizanëve në kuptimin klasik të tyre në Kosovë e shohim që nga shtatori i vitit 1942.

³³ Ibid., 165.

³⁴ Ibid., 165-66.

³⁵ Alexandra De Renzy Channer, "Defeat and Resurrection: A Political History of the Pan-Albanian National Revolutionary Movement, 1912-2010," 223.

³⁶ Josip Broz Tito, "Zhvillimi i Luftës Çlirimtare të popujve të Jugosllavisë në lidhje me ngjarjet ndërkombëtare (Raporti në Mbledhjen e Dytë të Këshillit Antifashist të Çlirimit Kombëtar të Jugosllavisë)," *Përparimi*, nr. 5 (1983): 638.

Në këtë rast, viti 1943 është posaçërisht i rëndësishëm për trajektoren historike të luftës guerile, duke qenë që shënon kohën kur partizanët në Kosovë morën hov dhe e zgjeruan ndikimin dhe kontrollin e tyre ndër popullatën vendase, gjë që mund të konsiderohet si një transformim drastik i mbështetjes popullore krahas mbështetjes së vitit paraprak (1942), kur partizanët sapo kishin filluar veprimtarinë e tyre në Kosovë.

Në një kuptim më të gjerë, lufta guerile definohej si një nismë revolucionare që ka për qëllim të përfshijë popullatën civile në mbështetje të kauzës së tyre dhe të luftojë kundër një autoriteti dominant që mund të perceptohet si pushtues nga vetë guerilët dhe nga popullata civile.³⁷ Megjithëse veprimtaria e partizanëve nuk është e kufizuar vetëm në ngritjen e mbështetjes nga ana e popullatës civile, në shumë raste efikasiteti i luftës guerile është në vartësi të drejtpërdrejtë me mbështetjen e dhënë nga popullata civile, të cilët përmes strehimit të guerilëve dhe duke mos treguar për vendndodhjen e tyre, e pamundësojnë pushtuesin të luftojë guerilët.

Gjatë periudhës për të cilën po diskutohet, partizanët përvetësuan taktika guerile, që e përvetësuan emërtimin kallëzues universal “partizan” për të bërë të ditur bindjet ideologjike nga të cilat ata udhëhiqeshin, ideologji të cilat kanë për bazë parimet marksiste-leniniste, dhe që të sqarojnë se shërbejnë si pararojë ushtarake e një partie politike që përvetëson këtë ideologji.³⁸ Këto bindje e definojnë cakun përfundimtar të partizanit dhe luftës guerile për mirëqenie universale si kauzë e luftës së tyre. Andaj, që nga definicioni, partizani lufton kundër një fuqie të huaj pushtuese³⁹, gjë që ata e shfrytëzojnë si pretekst për justifikimin e veprave si obligim ndaj atdheut.⁴⁰ Thirrja për të mbrojtur atdheun (se për cilin atdhe bëhej fjalë, ishte çështje që i lihej hapësirë për interpretim varësisht nga cilët aktorë përdorej si parullë) megjithëse një parullë e përdorur njëjtë si nga fashistët ashtu edhe nga komunistët, ishte posaçërisht e përhapur ndërmjet partizanëve shqiptarë të Kosovës, siç vërehet edhe në korrespondencat

³⁷ Robert Taber, *War of the Flea: The Classic Study of Guerilla Warfare* (Brassey's, 2002), 14.

³⁸ Për referencë historike, të dhënat historike janë të paraqitura në trajtesat historike të cilat flasin për përhapjen e mësimëve marksiste-leniniste si veprime paralele të partizanëve/guerilëve. branko boshkoviq, “batalioni partizan sulmues i Kosovë-Metohisë” Andrijević, më 1944”, *Përparimi*, nr. 7-8 (1964): 491.

³⁹ Dirk Freudenberg, *Theorie des Irregulären: Partisanen, Guerillas und Terroristen im modernen Kleinkrieg* (Wiesbaden: VS Verlag für Sozialwissenschaften, 2008), 251-252.

⁴⁰ Gregor Schöllgen, *Krieg: Hundert Jahre Weltgeschichte*, 1. Auflage (München: Deutsche Verlags-Anstalt, 2017), 171.

ndërmjet partizanëve përgjatë vitit 1943. Agjitacioni dhe propaganda si vegël thelbësore e partizanit për të grumbulluar mbështetje⁴¹, kur për audiencë kishte partizanët shqiptarë, përpos që mbante në vete thirrje të natyrës marksiste-leniniste, ajo përfshinte edhe nuanca të thirrjeve nacionaliste - posaçërisht kur bëhej thirrja për çlirim kombëtar, ku armiku portretizohej si borgjezia në përgjithësi e më specifikisht si borgjezia e Mbretërisë jugosllave, si epitomi i vet natyrës koloniale të Mbretërisë jugosllave. Nga këtu e shohim një trajktore leniniste të diskursit çlirimtar.

Mbretëria jugosllave kishte konotacione negative për popullatën shqiptare në Kosovë, andaj duke e shënjuar atë si armik ideologjik synohej të rritej mbështetja për njësitë partizane.⁴² Që kishte probleme të dukshme në një vazhdimësi të trajktores kohore gjatë luftës sa i përket marrjes së mbështetjes nga shqiptarët për kauzën nacionalçlirimtare shqiptare brenda diskursit komunist, kryesisht ngaqë frika për ripushtim malazez, serb dhe maqedonas ishte reale, ishte evidentuar edhe nga udhëheqësit e UNÇ-së në Kosovë.⁴³ Për këtë arsye, ngritja e mbështetjes së dhënë nga popullata shqiptare e Kosovës ishte proces i vështirë, andaj dhe kjo çështje adresohet në mënyrë të vazhdueshme nga Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Jugosllavisë.⁴⁴ Natyra e luftës partizane në Kosovë përfshinte në thelb tri karakteristika: ishte e parregullt në kuptimin e formimit të njësive dhe në sulmet që ata i ndërmerrnin, partizanët kishin lëvizshmëri të madhe që vinte si pasojë e armatimit të lehtë që mbanin dhe numër të vogël të anëtarëve të njësive partizane, si dhe karakteristika e tretë ishte që pjesëmarrësit fillestarë që i përkitnin kombësisë shqiptare kishin bindje ideologjike të majta.⁴⁵

Tipare të tjera tipike për guerilen vëreheshin gjithashtu në të gjitha nismat ushtarake që i nisnin, ku preferonin të kryenin sulme të vogla por të shpejta. Ata gjithashtu vepronin në terren malor, që paraqet terrenin e preferuar të partizanit, meqë në këtë mënyrë ata e kanë më të lehtë të fshihen

⁴¹ Robert Taber, *War of the Flea: The Classic Study of Guerrilla Warfare*, 113.

⁴² Agjencioni Shtetëror i Arkivave të Kosovës (më tej: *ASHAK*), Fondi: Komiteti Krahinor i Lidhjes së Komunistëve të Kosovës, viti 1943, kutia 7, signatura 127.

⁴³ Izber Hoti, *Të dhëna të panjohura për Luftën e Dytë Botërore në Kosovë (1941-1945)* (Prishtinë: Instituti i Historisë - Prishtinë, 1999), 159-60.

⁴⁴ *ASHAK*, Fondi: Komiteti Krahinor i Lidhjes së Komunistëve të Kosovës, kutia 7, signatura 127.

⁴⁵ Carl Schmitt, *Theorie Des Partisanen* (Duncker & Humblot, 1975), 15. Fadil Hoxha, *Kur pranvera vonohet. (Fragment nga ditari - 1943)* (Prishtinë: Rilindja, 1965), 65. Milovan Djilas, *Memoir of a Revolutionary* (New York: Harcourt Brace Jovanovich, 1973), 93.

në rast se trupat ushtarake të rregullta nisin sulm ose kundërsulm drejt tyre.⁴⁶ Shkathësia e tyre në lëvizje ishte vërejtur edhe kur kishin organizuar sulme ndaj kundërshtarëve dhe kur menjëherë ishin shkapërderdhur.

Njësi i parë partizan në Kosovë u formua më 27 shtator të vitit 1942, dhe në atë pikë kishte vetëm 12 njerëz të armatosur.⁴⁷ Njësi quhej “Zenel Hajdini”, dhe fillimisht vepronte në regjionin e Rrafshit të Kosovës. Pas përafërsisht pesë muajsh, në janar të 1943, numri i të armatosurve në këtë njësi u rrit, me të cilin rast u nda në dy grupe, kështu duke e formuar edhe njësitin e quajtur “Emin Duraku”, i cili vazhdoi veprimtarinë e tij në Rrafshin e Dukagjinit.⁴⁸ Më pastaj u formuan tri njësite të tjera, të cilat përbëheshin nga partizanë të kombësisë shqiptare dhe serbe, gjë që mbështetej nga Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Jugosllavisë si formë e shtyrjes përpara konceptit të barazisë ndërmjet popujve.⁴⁹

Gjatë dy viteve në vijim, u themeluan edhe një numër më i madh i njësiteve partizane⁵⁰, veprimtaria e të cilave ishte e organizuar në dy zona operative, ku zona e parë përfshinte hapësirën ndërmjet Prizrenit dhe Kukësit, dhe zona e dytë përfshinte Malësinë e Gjakovës.⁵¹ Përkundër nismave të organizimit të njësiteve, partizanët e Kosovës po kritikoheshin nga Komiteti Qendror për mungesë disipline dhe mungesë të besnikërisë ndaj partisë, dhe po akuzoheshin për abuzim të pushtetit që kishin, sado i vogël që ishte ai. Qarkoret dhe raportet zyrtare të Komitetit Qendror vazhdimisht i vënin theksin rëndësisë që mbanin partizanët si faktorë politikë, por në të njëjtën kohë edhe si ushtarë shëmbëlltyrë që nuk duhej keqpërdorur pozitën e privilegjuar politike.⁵² Kritikat që njësitet partizane kosovare i morën nga Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Jugosllavisë u përhapën në një periudhë të përçarjes. Shfaqja e mosmarrëveshjes ndërmjet Svetozar Vukmanoviq-Tempo⁵³ dhe shqiptarëve partizanë

⁴⁶ Freudenberg, *Theorie des Irregulären: Partisanen, Guerillas und Terroristen im modernen Kleinkrieg*, 289.

⁴⁷ Velimir Terzić, *Oslobodilački rat naroda Jugoslavije 1941-1945*, vëll. 2 (Beograd: Vojnoistorijski institut, 1963), 319.

⁴⁸ Rreth formimit të zonave operative në Kosovë të njërive partizane, shih *Zbornik DNOR*, Ser.I, vol.19, dok.27, dok. 32, dok. 49, dok. 137.

⁴⁹ ASHAK, Fondi: Komiteti Krahinor i Lidhjes së Komunistëve të Kosovës, viti 1943, kutia 7, signatura 128.

⁵⁰ Si Brigada e 2-të e Kosovës e cila u formua në Bujanoc.

⁵¹ Arkivi i Institutit të Historisë - Prishtinë, NAW, kutia 1, T 313, fisha 208, 7470684.

⁵² ASHAK, Fondi Komiteti Krahinor i Lidhjes së Komunistëve të Kosovës, viti 1943, kutia 7, signatura 128.

⁵³ Tempo mund të cilësohet si personazh problematik brenda trajektores sonë historike, ngaqë duket se sikur që nga fillimi i angazhimit të tij si i deleguar për të ngritur rezistencën

reflektonte negativisht në njësitë partizane të shqiptarëve kosovarë nga këndvështrimi i Komitetit Qendror, megjithatë ata bënë një përshtypje të madhe pozitive mbi popullsinë shqiptare kosovare, përkrahja e të cilëve ndaj partizanëve filloi të rritet gradualisht.

Mbështetja në rajonin e Prishtinës u rrit dukshëm edhe pas funeralit të Murat Pacit në nëntor të vitit 1943, ku komunistët dhe simpatizantët shqiptarë të çështjes komuniste mbajtën fjalime, ku pas përmbylljes së tyre, 18 shqiptarë u burgosën. Kundërshtimi ndaj komunistëve shqiptarë i rriti pakënaqësitë e popullatës shqiptare në raport me veprimtaritë e Fuqive të Boshtit në pushtet, situata këto që në anën tjetër prodhuan mbështetje të shqiptarëve për komunistët. Në një mënyrë të ngjashme, reagimi ndaj partizanëve dhe civilëve gjatë gjithë vitit 1943, dhe veçanërisht në nëntor të vitit 1943, si pasojë e pamundësisë për të përzgjedhur dhe sulmuar në mënyrë selektive kryengritësit nga civilët, shtoi ankesat e popullatës lokale dhe më pas krijoi mbështetje për kryengritësit.⁵⁴

Këto vëzhgime historike mund të na ndihmojnë të kuptojmë sesi antipatitë etnike diktuan mënyrën në të cilën një parti e identifikuar me një grup etnik i zmbropsë anëtarët e grupeve kundërshtarë, të cilët më pas tërhiqen nga partia primare.⁵⁵ Antagonizmat ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve penguan që komunizmi të promovohet si ideologji e një sistemi shtetëror dhe shoqëror, që para së gjithash, kërkon krijimin e një shoqërie

ndër shqiptarët e Kosovës dhe Maqedonisë kishte qenë kritik ndaj qasjes së PKS-së në raport me krijimin e brigadave dhe batalioneve shqiptare. Për Tempon, duket sikur rezistenca komuniste brenda diskursit shqiptar ishte kundërtënëse, ndërsa rezistenca komuniste jugosllave jo dhe aq. Kundërshtimet logjike në qasjen e Tempos shfaqën edhe në qëndrimin e tij destruktiv në raport me Kuvendin e Mukjes, por edhe në përgjithësi në raport me krijimin e brigadave shqiptare. Shih Holm Sundhaussen, *Geschichte Jugoslawiens 1918-1980* (Stuttgart: Kohlhammer, 1982), 132-33. Kur Svetozar Vukmanovic Tempo publikoi memoarin e tij *Revolucija koja teče*, në to ai tentoi të zvogëlojë rolin e partizanëve shqiptarë në Luftën Nacionalçlirimtare, dhe në këtë formë e zgjeroi shtegun për rindërtimin e një ligjërimi shtypës në raport me shqiptarët. HU OSA 300-8-47-4-4, "Situation Report: Albania and Yugoslavia, 23 March 1971", 23 March 1971, faqe 1-3, Records of Radio Free Europe/Radio Liberty Research Institute: Publications Department: Situation Reports; Open Society Archives at Central European University, Budapest. (<http://hdl.handle.net/10891/osa:fcae37b0-e3e4-4b0b-9dcd-805ae4071a75>). Në kujtimet e tij *Titistët*, Enver Hoxha e përshkruan Tempon si një bartës i qëllimeve megalomane dhe hegjemoniste të udhëheqjes së PKJ për të sunduar Ballkanin. Enver Hoxha, *Titistët: Shënime historike* (Tiranë: 8 Nëntori, 1983), 54.

⁵⁴ AIHP, F. Regjistrimi i viktimitave të Luftës së Dytë Botërore, Këshilli Ekzekutiv Federal i Jugosllavisë, M 11- M 306.

⁵⁵ Donald L Horowitz, *Ethnic Groups in Conflict* (Berkeley: University of California Press, 1985), 542.

të barabartë, ku dallimet klasore dhe etnike janë të tejkaluara.⁵⁶

Këto ankesa për tensionim të situatës ndëretnike u treguan të vështira për t'u kapërcyer posaçërisht kur bëhej fjalë për nxitje të masave për të siguruar mbështetje për Partinë Komuniste të Jugosllavisë, e cila te popullata shqiptare nuk asociohej me ndonjë lëvizje internacionaliste, por me kombësinë serbe dhe malazeze. Si pasojë, për partizanët shqiptarë të Kosovës përkrahja thirrej në emër të Partisë Komuniste të Shqipërisë, e cila ishte më e favorizuar nga shqiptarët vendorë, pasi nuk shihej si promovuese e agjendave të huaja dhe armiqësore.

Në një letër të Svetozar Vukmanoviq-Tempos, e shohim që ai i kritikon ashpër komunistët nga Kosova për përqafimin e pikëpamjeve nacionaliste për referimin ndaj qyteteve të Vushtrrisë, Mitrovicës dhe Podujevës, të cilat në atë kohë ishin nën sundimin të huaj, si territore të pushtuara që duhej të liroheshin. Tempo vazhdoi të argumentonte se qëndrime të tilla promovojnë idenë e një Shqipërie të Madhe dhe janë në përputhje me idetë e promovuara nga Balli Kombëtar, të cilat janë kundërproduktive ndaj kauzës komuniste.⁵⁷ Edhe këtu shohim tipare të qasjes antikolonialiste të komunistët shqiptarë, e për më tepër edhe tipare të dinamikës koloniale të komunistët jugosllavë. Një tjetër element për t'u vënë re këtu është edhe roli i komunistëve shqiptarë të Kosovës karshi ngritjes së vetëdijes së përgjithshme kombëtare për luftë antikoloniale. Kjo qasje madje u diskutua edhe në Konferencën e Dytë Nacionalçlirimtare të mbajtur në Labinot në shtator të 1943, përkundër që këtë rol e mori formalisht përsipër Lëvizja Nacionalçlirimtare në tërësi,⁵⁸ gjë që konfirmohet edhe nga burimet arkivore të akterëve të luftës nga Kosova.⁵⁹

Në një mënyrë të ngjashme, Tempo kritikoi partizanët shqiptarë të Kosovës duke i etiketuar ata si anëtarë të një ushtrie të veçantë, e cila nuk ishte pjesë e Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë, por që në fakt e paraqisnin veten si pjesë e Fronit Nacionalçlirimtar të Shqipërisë, me të cilin rast Tempo dha urdhra që të ndërpritet kjo formë e veprimi.⁶⁰ Kjo dhe letra të tjera me tone të ngjashme kritike, përshkruajnë situatën në të cilën shihet që shqiptarët dhe serbët po luftonin për caqe krejtësisht të ndryshme. Ndonëse është e vështirë të argumentohet se kjo ishte krejtësisht e

⁵⁶ Freudenberg, *Theorie des Irregulären: Partisanen, Guerillas und Terroristen im modernen Kleinkrieg*, 298.

⁵⁷ ASHAK, Fondi: Komiteti Krahinor i Lidhjes së Komunistëve të Kosovës, viti 1943, kutia 7, signatura 741.

⁵⁸ Ana Lalaj, *Dosjet e Luftës* (Tiranë: Botimet Toena, 2014), 218.

⁵⁹ Arkivi Qendror Shtetëror, F. 14/AP-PKSH, V. 1943, D. 39. Marrë nga Ibid., 219.

⁶⁰ *Zbornik DNOR*, Ser II, vol. 10, doc. 16.

rastësishme, është e qartë se deri në fund të vitit 1943 partizanët shqiptarë të Kosovës po promovonin një agjendë për ngritjen e pozitës së tyre kombëtare brenda diskursit antikolonial. Ata po vepronin si të bashkuar me Shqipërinë si shtet amë, brenda një diskursi ku ideja e integritetit të Shqipërisë brenda Federatës Jugosllave ishte e hapur.⁶¹

Në një letër qarkore të dërguar nga Fadil Hoxha për partizanët nën komandën e tij, ai vazhdon të tregojë se si morali i luftëtarëve të tij ishte rritur që kur partizanët shqiptarë të Kosovës filluan të mbanin konferenca dhe takime për qëllime arsimore rreth marksizmit-leninizmit me të rinjtë, dhe se si në atë pikë ata po vendosnin bazat për të formuar dy njësi partizane shitesë. Ai pohoi se partizanët shqiptarë të Kosovës kishin krijuar një program ditor që synonte të edukonte dhe informonte partizanët dhe civilët rreth komunizmit. Letra përfundon duke i informuar partizanët se kishin festuar Ditën e Flamurit kombëtar duke ngritur flamurin shqiptar dhe duke kënduar këngë komuniste patriotike të shkruara nga Lame Kodra, pseudonimi i Sejfulla Malëshovës.⁶² Çështja e së ardhmes së Kosovës u diskutua gjithashtu midis anëtarëve të PKJ-së dhe vetë kuadrove partizane.

Në një letër dërguar Pavle Joviqeviqit nga Miladin Popoviqi, në dhjetor të 1943 ky i fundit pretendon se çështja e Kosovës duhet të zgjidhet në bazë të Kartës Atlantike, duke ruajtur kështu kufijtë e vjetër të Mbretërisë së Jugosllavisë.⁶³ Megjithëse një korrespondencë e tillë nuk tregon plotësisht se politikat dhe idetë e PKJ-së në lidhje me Kosovën ishin koloniale, ekzistenca e qëndrimeve të paqarta (veçanërisht në lidhje me interpretimin se kush ka të drejtën e vetëvendosjes) dëshmon se ka pasur përpjekje minimale në zgjidhjen e çështjes së shqiptarëve dhe përmirësimin e statusit të tyre brenda Jugosllavisë. Qëndrimi i mbajtur nga kuadro më të lartë të Partisë në lidhje me zgjidhjen e statusit të Kosovës u perceptua negativisht nga komunistët shqiptarë të Kosovës gjë që shkaktoi pakënaqësi në mes të dy grupeve.

Në fund të dhjetorit të vitit 1943, Këshilli Nacionalçlirimtar i Kosovës dhe Rrafshit të Dukagjinit mbajtën konferencën e parë të Këshillit, ku deklaruan se lufta e tyre ishte kundër *“pushtuesve nazistë dhe mercenarëve të tyre”*, dhe më tej vazhdon se kjo do të ishte e vetmja mënyrë që ata të fitojnë *“lirinë e të gjithë popujve, duke përfshirë edhe popullin*

⁶¹ Ana Lalaj, *Dosjet e Luftës*, 379; Agim Zogaj, *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave dhe çështja e Kosovës, 1945-1948* (Prishtinë, 2015), 33.

⁶² ASHAK, Fondi: Komiteti Krahinor i Lidhjes së Komunistëve të Kosovës, viti 1943, kutia 7, signatura 153.

⁶³ ASHAK, Fondi: Miladin Popovic, kutia nr. 2, pa numër.

shqiptar... duke vendosur për fatin e tyre me të drejtën për vetëvendosje dhe madje edhe shkëputjen", garantuesi i të cilit do të ishte aspirata Ushtria Nacionalçlirimtare e Jugosllavisë dhe Ushtria Nacionalçlirimtare e Shqipërisë.⁶⁴

Rezoluta 6 faqshe u nënshkrua nga Mehmet Hoxha, Pavle Joviqeviqi, Rifat Berisha, Xhevdet Doda, Fadil Hoxha, Hajdar Dushi dhe Zekeria Rexha.⁶⁵ Kjo erdhi si përgjigje ndaj takimit të dytë të Këshillit Nacionalçlirimtar Antifashist të Jugosllavisë (AVNOJ - Antifašističko vijeće narodnog oslobođenja Jugoslavije), mbajtur në Jajcë të Bosnjës, më 29 nëntor 1943, ku Komiteti Qendror u shndërrua në një organ ekzekutiv të shtetit federal.⁶⁶ Sipas vendimeve që u morën në këtë konferencë, shqiptarët e Kosovës u vendosën në pozitë jo të favorshme brenda shtetit federativ të përbërë nga gjashtë republika sllave.⁶⁷ Ky veprim u interpretua si një vazhdim i politikave koloniale ndaj Kosovës nga një numër i komunistëve, dhe për më tepër vendimi i Jajcës konsiderohej të ishte në kundërshtim me deklaratën e Kartës Atlantike për respektimin e parimeve të vetëvendosjes së popujve.⁶⁸ Deri në fund të vitit 1943, mundësia reale që ushtria gjermane të pësonte disfatë ishte e afërt. Këto kthesa të ngjarjeve e shtuan më tej përkrahjen për partizanët nga vendasit, disa prej të cilëve kishin frikë nga burgosjet masive pas fitores së partizanëve. Pasi partizanët shpallën fitore në nëntor të vitit 1944, çështja e Kosovës mbeti e pazgjidhur dhe partizanët luftuan ndjeshëm në marrjen e kontrollit të plotë të territorit. Zvarritja e zgjidhjes së çështjes së Kosovës gjatë gjithë luftës e shndërroi të parëndësishme në sytë e Partisë zgjidhjen e saj me kalimin e kohës, gjë që sikur të adresohet me kohë, ndoshta edhe do të parandalonte rikrijimin e një dinamike koloniale karshi shqiptarëve nën Jugosllavi e do t'i parandalonte ngjarjet e dhunshme që ndodhën gjatë viteve '50, '60, '80 dhe së fundi gjatë viteve '90 të shekullit të kaluar.

⁶⁴ ASHAK, Fondi: Komiteti Krahinor i Lidhjes së Komunistëve të Kosovës, viti 1942 (1945), kutia 23, signatura 10.

⁶⁵ Pa autor, "Popuj të Kosovë-Metohisë, vllazen të të gjitha kombëve e feve," *Përparimi*, nr. 5 (1983): 669-74.

⁶⁶ Në Jajcë, Tito mori gradën e marshallit, e shpalli të papushtetshëm qeverinë jugosllave në ekzil, dhe e ndaloi kthimin e Mbretit Petar në Jugosllavi - sipas Banacit, të gjitha këto pa e informuar Stalinin, gjë që Stalini e kishte interpretuar si mosbindje. Shih Ivo Banac, *With Stalin against Tito: Cominformist Splits in Yugoslav Communism* (Ithaca: Cornell University Press, 1988), 12.

⁶⁷ Thomas Taylor Hammond, *The Anatomy of Communist Takeovers* (New Haven: Yale University Press, 1975), 256.

⁶⁸ Pa autor, "Deklarata e mbledhjes së dytë të Këshillit Antifashist të Çlirimit Kombëtar të Jugosllavisë," *Përparimi*, no. 5 (1983).

Mrika LIMANI-MYRTAJ

Summary

PERSPECTIVES ON ANTI-COLONIAL ELEMENTS DURING THE SECOND WORLD WAR IN KOSOVO

The paper follows the trajectory of emerging anti-colonial narratives in the Albanian sphere during the Second World War. It attempts to highlight how both nationalist and communist groups adopted an anti-colonial narrative within their political discourse.

The paper particularly focuses on the anti-colonial resistance during the years 1942-1944, and the ideological platform of partisans adopted as well as their stance towards foreign occupation. While the groups are initially aligned with the Communist Party of Yugoslavia, in that they operate within its structures, the Albanian partisans in Yugoslavia begin to affiliate themselves more with the Albanian Communist Party. In following this historical trajectory, we notice that they begin to develop this closeness as a response to a potential solution to the Albanian national question, in hopes that national liberation can be achieved as a joint communist undertaking in achieving equality among nations through self-determination as promoted by the Comintern. Despite these ideological inclinations, it becomes swiftly apparent that the Yugoslav Communist cadres do not favor this approach and criticize the Albanian partisans for promoting nationalist ideologies similar to those of the National Front. The national question is thereafter overruled and with it an abundance of issues left unresolved.

